

Haxhi ADEMI

**JETA POLITIKE NË KOSOVË NË VITET E LUFTËS SË
DYTË BOTËRORE (1941-1945)**

Punimi trajton jetën politike në Kosova në vitet e Luftës së Dytë Botërore, kohë kur këto territore ishin pushtuar dhe ndarë në tri zona. Pavarësisht nga prania e fuqive pushtuese, në Kosovë kishte një elitë politike e cila kryente veprimtarinë e saj. Si i tillë punimi është i bazuar në burime arkivore që e dokumentojnë këtë periudhë tejet dramatike, ngase rryma të ndryshme (Partia Fashiste, Lidhja Popullore, Balli Kombëtar, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Partia Komuniste e Jugosllavisë, Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare etj.), përplaseshin pikërisht në Kosovë, duke sjellë tensione të vazhdueshme brenda saj. Gjithashtu punimi është mbështetur dhe në rezultatet e historiografisë shqiptare dhe atë të huaj. Në këtë punim shtjellojmë subjekte politike (themelimin, anëtarët, frymë-programin, aktivitetet dhe ndikimin), për të parë rolin e tyre në proceset politike në Kosovë në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Partia Komuniste e Jugosllavisë (PKJ) dhe shtrirja e saj në Kosovë - megjithëse rrethanat e përgjithshme në Kosovë gjatë viteve '30-të ishin tejet të vështira, si pasojë e qëndrimit që mbante Beogradi zyrtar ndaj popullsisë shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë, pikërisht në këtë periudhë janë krijuar celulat e para të PKJ-së në Kosovë në rrethana ilegaliteti. Kështu, në qytetin e Pejës më 1931 ishte formuar i ashtuquajti Komiteti i Qarkut të PKJ-së i Metohisë që të zhvillonte aktivitete jo vetëm brenda në qytetin e Pejës po edhe në rrethinën e tij. Më pas, celulat e para të PKJ-së u themelua edhe në qytetet e tjera si në: Prizren (1931), Prishtinë (1932), Ferizaj (1936) etj. Por, me zbulimin e veprimtarisë së saj, u shua PKJ për Kosovë, për t'u rishfaqur sërish më 1937, kur në krye të partisë erdhi Josip Broz Tito, i cili bëri një kthesë në punën e PKJ-së duke mos përjashtuar as Kosovën.¹

¹ Arkivi i Institutit të Historisë në Prishtinë, (më tej: AIHP) Fondi (më tej: F) 44, fl.35-39. Kosova në Mbretërinë e Jugosllavisë.

Është me rëndësi të theksojmë se Konferenca e Parë e PKJ për qarkun e Kosovës (Oblasni Komitet KPJ za Kosovo i Metohiju) ka rëndësi së pari, sepse u formua Komiteti i Qarkut që ishte hapi i parë për njohjen e pozitës autonome të kësaj treve; së dyti, tanimë kryesonin udhëheqësit qarkorë të partisë që në fakt krijoi mundësi për një punë më të mirë dhe më të organizuar; së treti, vendimet që u morën, të cilat gradualisht u zbatuan në praktikë nga fundi i vitit 1937. Kontributin më të madh për të formuar Komitetin Qarkor dhe për të studiuar rreth organizimit dhe shtrirjes së PKJ-së në Kosovë e dhanë Milladin Popoviqi dhe Radovan Vukoviq, dhe i deleguari i KQ të PKJ-së, Moma Markoviq.²

Pas Konferencës së parë filluan aktivitetet për riformimin e organizatave të reja partiake. Komiteti i Qarkut, tashmë mbante lidhje të drejtpërdrejta me Gjakovën, Mitrovicën, Prishtinën, Vushtrrinë si dhe me vendet e tjera, ku kishin filluar të organizoheshin celulat e reja partiake.³ Por, PKJ në Kosovë para Luftës së Dytë Botërore ishte e dobët. Ajo thjesht ishte një degëzim i një organizate të madhe sllave. Në verën e vitit 1940 në Kosovë kishte 239 anëtarë të PKJ-së, prej të cilëve 25 ishin shqiptarë, ku pjesëmarrja kaq e vogël e shqiptarëve lidhet më faktin se strukturat udhëheqëse të PKJ-së ishin sllavë dhe për këtë arsye shqiptarët hezitnin t'ju bashkëngjiteshin. Këtë më së mirë e dëshmon fakti se një vit më vonë pjesëmarrja e shqiptarëve bije. Një vit më vonë, me fillimin e luftës, numri i anëtarëve të kësaj partie u rrit në 270, ndërsa numri i anëtarëve shqiptarë zbriti në 20.⁴ Por, PKJ në Kosovë aktivitetin e saj e zgjeroi në veçanti pas demonstratave të vitit 1941, prej të cilave veçojmë atë të 11 majit 1941 në Pejë. Në këtë demonstratë morën pjesë mijëra qytetarë, me kërkesat për të mbrojtur vendin nga pushtimi dhe kërkesa të tjera si, barazia kombëtare për shqiptarët, serbët e malazezët.⁵ Protestat në Pejë dhe gjithandej në Kosovë nuk përfunduan pa incidente, ngase organet e rendit gjuajtën edhe me armë kundër protestuesve, dhe për pasojë u plagosën 11 qytetarë, ndërsa një numër tjetër i demonstruesve për t'i ikur marrjes në pyetje, dhe më pas dhunës fizike e psikike, u larguan në ilegalitet.⁶ Gjatë vitit 1942, aktivistët dhe anëtarët e Partisë Komuniste në Kosovë ishin të paktë. Por, nga shtatori

² Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1981, 320.

³ Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë: Rilindja, 1971, 37-40.

⁴ AIHP, F. Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Nr.20, fl.8.

⁵ Foliqi, "Puna e PKJ në Kosovë", 713.

⁶ Millutin Foliqi, "Puna e PKJ në Kosovë-Metohi në vijën ushtarake në pragun dhe gjatë luftës së prillit të vjetit 1941", Përparimi, Nr.11-12/1965, 713.

i vitit 1942 u formuan grupet e para partizane shqiptare.⁷ Kompleksiteti i ngjarjeve të shumta dhe të papritura ndikonte në ngecjen e organizimit të luftës, të cilën duhej ta bënte Komiteti i Qarkut të PKJ për Kosovën, por që dihej dyshimi dhe frika nga ky subjekt, madje edhe ndaj komunizmit si ideologji.

Në anën tjetër, qëndronte frika e rrëshqitjes së Shqipërisë drejt kampit nazifashist, ngase vazhdimisht ata propagandonin që, në rast se do të gjenin përkrahjen e Shqipërisë, asaj do t'i bashkoheshin territoret e shkëputura në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, më 1913. Po ashtu theksojmë edhe faktin se, Shqipëria ishte sateliti i Italisë dhe ndikimi i Benito Musolini (Benito Mussolini-Duçë) u zgjerua edhe më shumë në Ballkan, ndërsa veriu (rrethi i Mitrovicës) u vendos nën administrimin ushtarak gjerman, por formalisht mbeti pjesë e shtetit të ri serb, i cili gjendej nën kontroll të Reich (Rajhut) të Tretë.⁸

Mirëpo, ishin anglezët ata të cilët vazhdimisht e këshilluan Shqipërinë që të mos anonte nga nazifashistët, duke i thënë se ajo është pjesë e Koalicionit të Aleatëve dhe se është e pozicionuar nga ana e shteteve demokratike. Andaj, Shqipëria duhej të kishte parasysh rreziqet në rast se do të përkrahte nazifashistët, ngase ishte e sigurt se ata nuk do të ndihmonin bashkimin e territoreve të saj. Edhe pse në njëfarë mënyre Italia realizoi bashkimin e një pjese të madhe të territoreve shqiptare, motivacionet e së cilës shqiptarët i kishin mjaft mirë të ditura.⁹

Partia Fashiste Shqiptare - për të shtrirë ideologjinë fashiste në Shqipëri dhe në përgjithësi në trojet shqiptare, italianët, pas pushtimit të Shqipërisë, me vendim të Këshillit të Ministrave e me dekret të Mëkëmbësit të Përgjithshëm në Tiranë, formuan Partinë Fashiste Shqiptare (PFSH).¹⁰ PFSH, kishte lidhje tejet të ngushta me Partinë Fashiste Italiane, madje ishte themeluar prej saj. Kështu, një javë pas miratimit të statutit, në Shqipëri erdhi sekretari i përgjithshëm i Partisë Fashiste Italiane, Akile Starace, i cili

⁷ AIHP, F. Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Nr.20, fl.8.

⁸ Oliver Jens Schmitt, *Kosova, histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë: Koha, 2012, 165.

⁹ *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2008, 131-132.

¹⁰ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Dosja (më tej: D.) 295, Viti (më tej: V.) 1939, fl.1. Dekret i Mëkëmbësit të Përgjithshëm, Francesko Jakomoni, për miratimin e Partisë Fashiste Shqiptare; Andrea Di Nocola, *Ngritja dhe rënia e Partisë Fashiste Shqiptare* (1939-1943), Tiranë: Botart, 2013, 16.

në praninë e një turme të madhe njerëzish, të mbledhur me detyrim në sheshin “Skënderbeu” shpalli krijimin e PFSH-së.¹¹

Anëtarësimi në PFSH ishte i detyrueshëm për të gjithë nëpunësit e shtetit. Madje, në bazë të qarkores së 3 korrikut 1940, jo vetëm nëpunësit por edhe zonjat e tyre duhet të regjistroheshin në këtë parti.¹² Më pas, të njëjtën rrugë duhej që të ndiqte edhe ministri i Arsimit, Ernest Koliqi, dhe gjithë personeli arsimor. Andaj, në bazë të qarkores së datës 11 korrik 1940, Koliqi urdhëronte të gjithë drejtoritë e shkollave, mësuesit dhe nxënësit të lidheshin me PFSH.¹³

Përfshirja e simbolikave fashiste në flamurin kombëtar e irritoi popullin shqiptar dhe si rezultat i këtij veprimi ata i dërguan një letër protestuese Musolinit, ku i kërkuan që të hiqen këto simbolika si “Sëpata e Liktorit” dhe “Stema e Sajovës”. Ky reagim kishte efektin e vet në ndërrimin e emrit të “Partisë Fashiste Shqiptare” PFSH në “Partia Fashiste Kombëtare Shqiptare” (PFKSH).^{*} Më pas u mor vendimi për zëvendësimin e Partisë Fashiste Shqiptare me një organizatë të re “Rojet e Shqipërisë së Madhe”.^{**} Ky ndryshim erdhi së bashku me vendimet e tjera, si krijimi i ushtrisë e xhandarmërisë si një forcë më vete.¹⁴

Në maj të vitit 1941, u nisën për në Kosovë, një grup prej 150 intelektualësh (mësues dhe administratorë) nga Shqipëria për nevojat e shkollës shqipe dhe administratës shtetërore në gjuhën shqipe. Mirëpo, për të shtrirë ideologjinë fashiste në zonën e pushtimit italian, në mesin e këtyre intelektualëve janë infiltruar edhe 20 italianë, anëtarë të Partisë Fashiste dhe të shërbimit informativ SIM, të cilët kishin për detyrë të bënin propagandë për zhvillimin e fashizmit në Kosovë. Me qëllim të zgjerimit të ideologjisë fashiste edhe në Kosovë, krerët e fashizmit hapën tri zyra të PFKSH-së, në

¹¹ AQSH, F.149, D.I/12, V.1939, fl.44. Vendimi i Këshillit të Ministrave.

¹² AQSH, F.149, D.I/86, V.1940, fl.46. Qarkore e Kryesisë së Këshillit të Ministrave, 3 korrik 1940.

¹³ AQSH, F.149, D.I/86, V.1940, fl. 23.

^{*} Ndërrimi i emërimit nga PFSH në PFSHK u bë me ardhjen në krye të qeverisë së Mustafa Krujës (4 dhjetor 1941-më 10 shkurt 1943) dhe kishte si qëllim joshjen e shqiptarëve dhe njëkohësisht pushtuesi italian synonte të dëshmonte se po respektonte dinjitetin e tyre kombëtar. Më gjerësisht: *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 51.

^{**} Pas një muaj të qëndrimit në krye të qeverisë së Eqrem Libohovës (10 janar- 22 shkurt 1943) u pasua nga Maliq Bej Bushati (22 shkurt 1943) - cili u përpoq të krijonte një përshtypje se do të ndiqte një politikë liberale që do të çonte shpejt në zbutjen e konflikteve shoqërore e kombëtare. *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 61.

¹⁴ *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 61.

Prizren, Pejë dhe në Prishtinë.¹⁵ Po ashtu, u formuan edhe njësitë më të vogla se federatat, nëpër nënprefektura dhe në disa komuna më të mëdha. Në qendrat urbane, u formuan grupe të vogla fashiste të lagjes. Grupi fashist i lagjes kishte më së paku dy sektorë, ndërsa sektori përbëhej nga dy deri në gjashtë bërthama dhe koordinonte veprimtarinë e tyre.¹⁶

Fashistët italianë bënë përpjekje që një brez i ri i shqiptarëve të përfshihej në aktivitete të ndryshme fashiste si: fëmijët në “Bilbila”, rinia e moshës 15-19-vjeçare në “avangardistë”, ndërsa ata më të vjetër në “giovani fashist”. Po ashtu, vlen të përmendet se kjo parti në tendencë për t’u shtrirë në zonën e pushtimit italian në Kosovë, ka organizuar formacione të armatosura me emra të ndryshëm si: “Fronti i trimave fashistë” (1942), “Për Mbrojtjen e Kombit” ose “Dora e Zezë”.¹⁷ Për kohën në të cilën ka vepruar kjo parti ka kryer veprimtari të dobishme siç ishte rasti i evidentimit të emrave të personave që janë vrarë nga pushteti serb. Këtu po ofrojmë disa lista, si listën e Ferizajt, që dëshmojnë për krimet serbe¹⁸ dhe bullgare¹⁹ në trojet shqiptare në periudhën 1912-1940. Si rezultat i këtyre krimeve, që janë listuar më lart dhe rrezikut nga çetat çetnike serbe dhe bullgare, anëtarët e kësaj partie kërkuan nga italianët mbi 50 000 armë në Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqiptare, me arsye për t’u mbrojtur nga krimet serbo-sllave.²⁰ Italianët vijuan tendencat për të shtrirë ideologjinë e tyre në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nëpërmjet politikës, kulturës, arsimit ekonomisë etj. Por, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme PFKSH-ja nuk mundi të shtrijë ideologjinë e saj në masat e popullsisë shqiptare në Kosovë.²¹

Lidhja Popullore Shqiptare (LPSH) - në zonën e pushtimit gjerman, statusi i qarkut të Mitrovicës, u bë ndër problemet kryesore. Me dekretligjin gjerman u mor vendim që ky qark të përfshihej në kuadër të qeverisë së Nediçit. Andaj, përfaqësuesit e “Komitetit të Kosovës”, duke qenë të

¹⁵ Muhamet Shatri, “Sistemi pushtues në Prizren dhe në rrethinë, 1941-1944”, Kosova, Nr.7.1978, 414.

¹⁶ Shatri, “Sistemi pushtues”, 414-415.

¹⁷ Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (më tej: AIDSSH), Fondi (më tej: F.) 6, Dosja (më tej: D.) 922, Viti (më tej: V.) V.1972, fl.20. Raport politik mbi gjendjen e Kosovës-Metohisë-Plavës e Gucisë.

¹⁸ AQSH, F.164, D.52, V.1943, fl.42. Shqiptarët të vrarë në vitin 1912-1914 nga serbët civilë të Ferizajt, Prishtinë 5 janar 1943.

¹⁹ AQSH, F.164, D.52, V.1943, fl.43-47. Shqiptarët të vrarë në vitin 1912-1940 nga ushtria ose komitetë bullgarë dhe serbë. Prishtinë 5 janar 1943.

²⁰ AQSH, F.146, D.52, fl.36. Mbi barbarizmat sllavë kundër shqiptarëve.

²¹ Hadri, “Sistemi i pushtimit”, 28; Shatri, “Sistemi pushtues”, 415.

pakënaqur me statusin e Mitrovicës, formuan në këtë qytet “Lidhjen Popullore Shqiptare”.²² Pra, në Mitrovicë, “Komiteti i Kosovës” rilindi si rezultat i besimit të gjerë se Boshti do ta humbiste luftën. Detyrë e këtij komiteti ishte ruajtja e rendit publik në Shqipëri, në veçanti në Kosovë, gjatë hyrjes së trupave aleate me qëllim shmangien e konflikteve midis serbëve e shqiptarëve, sikurse kishte ndodhur gjatë hyrjes së trupave gjermane. Kryetar i Komitetit në të njëjtën kohë ishte edhe kryetar i qeverisë, Iliaz Agushi. Anëtarë të tjerë të Komitetit ishin: Ferhat Bej Draga, Sefedin Beu nga Peja me vëllezërit e tij, Xhevatini dhe Rifatin, Sulejman Bej Kryeziu nga Gjakova, Bedri Pejani nga Peja, që jetonte në Shkodër dhe Rexhep Mitrovica.²³

Ndërsa nga burime të tjera mësojmë se në mbledhjen themeluese të LPSH-së morën pjesë shumë personalitete të jetës politike të këtij rajoni, si Bedri Pejani, Ali Draga etj. Përfaqësues u zgjodh Ali Draga, i biri i Ferhat Dragës.²⁴ Në këtë mbledhje, në fjalimin e tij, Bedri Pejani theksoi se “është e kotë të bisedohej me qeverinë serbe”. Por, megjithatë do të kërkohej nga pala serbe dhe gjermane rishqyrtimi i çështjes administrative, ngase sipas tij, meqenëse shqiptarët përbëjnë shumicën në këtë rajon, duhet ta kenë pushtetin në duart e tyre. Në qoftë se kjo nuk do të bëhej, ai do të kërkonte personalisht te Musolini, që të bisedonte me Hitlerin për rregullimin e kësaj çështjeje. Gjermanët ishin të prerë në qëndrimin e tyre për sa i përket diskutimit për autonominë e qarkut të Mitrovicës*. Administrata ushtarake gjermane i bënte të ditur përfaqësuesve të LPSH-së, se nuk do të kishte autonomi.²⁵

²² AQSH, D.I.1170, V.1941, fl.109. Raport mbi situatën e krijuar nga Bedri Pejani, P. Komitetin e Kosovës, për kryeministrin Shefqet Vërlacin, Mitrovicë, 1 korrik 1941.

²³ The National Archives and Record Administration (NARA) Office of Strategic Service (Zyra e Shërbimeve Strategjike) Washington, D.C., fl.1 Mbi gjendjen në Kosovë, raporti nr. G.1503. Shqipëri përmes Italisë, 18 shkurt 1944.

²⁴ Hadri, *Lëvizja*, 131.

* Në kuadër të zonës së pushtimit gjerman, për shkak të industrisë, minierave të Trepçës dhe pasurisë nëntokësore që ofronte ky rajon dhe për shkak të interesave strategjike të Gjermanisë u përfshinë këto territore të pjesës veriore të Kosovës: rajoni i Mitrovicës, Podujevës dhe Vushtrrisë. Territorët e sipërshënuara u përfshinë në kuadër të shtetit serb të Millan Nediqit. Por, serbët kishin edhe kërkesa të tjera për zgjerim. Kjo zonë për gjermanët kishte një rëndësi të veçantë ekonomike, në veçanti për makinerinë ushtarake. Madje, gjermanët përveç Trepçës dhe pjesës veriore të Kosovës në kuadër të sundimit të tyre nuk shmangën as minierat e tjera në Kosovë, siç ishte baseni i linjtit të Obiliqit, miniera e Goleshit, miniera e Jezercit etj.: Izber Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1998, 29.

²⁵ Daut Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë, 1941-1945*, Prishtinë: Instituti

Problemi i statusit të Mitrovicës dhe moszgjidhja e tij shkaktoi trazira ndëretnike. Kështu, gjatë vitit 1941, pati përplasje ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, ndërsa gjermanët ndërhyjnë për ta vënë nën kontroll situatën. Për t'i arritur qëllimit që të ketë sa më pak konflikte ndëretnike, përfaqësuesi gjerman organizoi disa tubime me qëllim pajtimi, në mes të përfaqësuesve shqiptarë dhe qeverisë së Nediqit. Për të njëjtin qëllim, në Nish u organizua një konferencë, ku palën gjermane e përfaqësonte koloneli Bothem, palën shqiptare Xhafer Deva, Ali Draga dhe Ibrahim Berisha, ndërsa atë serbe Kosta Millanoviq-Peçanac.²⁶ Në këtë konferencë, përfaqësuesit shqiptarë parashtruan disa kërkesa, si: përdorimin e gjuhës shqipe në administratë; formimin e një drejtorie të veçantë financiare për qarkun e Mitrovicës; të mbetej për një kohë të caktuar xhandarmëria shqiptare, të pranoheshin në administratë dhe në radhët e mësuesve e profesorëve, profesorët nga "Shqipëria e Vjetër" etj. Tri kërkesat e para u pranuan ndërsa dy të fundit jo, por u vendos që të aftësoheshin për punë administrative nëpunësit aktualë shqiptarë, të cilët ishin nga Kosova, por jo ata që kishin ardhur nga Shqipëria.²⁷

Lidhja Popullore Shqiptare ishte mjaft e përkushtuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e çështjes shqiptare në zonën e pushtimit gjerman si dhe bashkimin e kësaj zone me Shqipërinë duke përfshirë edhe Pazarin e Ri.²⁸ LPSH mendohej dhe punonte gjithnjë për vendosjen e gjuhës shqipe në administratë, hapjen e shkollave shqipe si dhe luftën e vendosur diplomatike e ushtarake kundër administrimit serb. Ajo punonte për demaskimin e politikës serbe në lidhje me pozitën e shqiptarëve, dhe për këtë qëllim më 24 prill 1942 organizoi një mbledhje me çetnikët Kosta Peçancin dhe me udhëheqjen e Rojës shtetërore serbe të Millan Nediqit. Kjo mbledhje u mbajt nën udhëheqjen e oficerit gjerman, dr. Trenerit. Nga pala shqiptare morën pjesë Ali Draga, Ibrahim Lutfiu dhe Pajazit Boletini, ndërsa nga pala serbe morën pjesë Millan Aqimoviq, kolonel Joviq dhe Jovan Bërkiq. Ndër të tjera, pala gjermane u njoftua për lëvizjet çetnike në këtë zonë që udhëhiqeshin nga Gavriol Vuçiterni, dhe kishin si qëllim vrasjen e civilëve shqiptarë dhe shpërnguljen e popullsisë shqiptare nga treva veriore të Kosovës, për ndryshimin e strukturës etnike, në favor të elementit sllav.²⁹

Albanologjik, 1997, 76.

²⁶ Shpresa Mekaj, "Përpyjekja e gjermanëve për t'i pajtuar shqiptarët dhe serbët më 1941", Vjetar, Nr. XXXI-XXXII/2004, 415-418.

²⁷ Bislimi, *Formacionet*, 77.

²⁸ Hadri, *Lëvizja*, 131.

²⁹ Po aty, 132.

Në kuadër të LPSH-së, vepronte “Organizata e Rinisë Shqiptare” e cila e orientonte punën e saj në fushën e edukimit të atdhedashurisë, ndërsa aktivitetet i zhvillonte në shkolla dhe vendtakimet e të rinjve. Kjo organizatë e zhvilloi aktivitetin e saj në të mirë të mbrojtjes së Shqipërisë etnike.³⁰

Balli Kombëtar (BK) - në dokumentet e kohës* si dhe në historiografinë shqiptare të periudhës komuniste, 1945-1990, andej dhe këtej kufirit, për Ballin Kombëtar kemi një përshkrim të njëanshëm. Për anëtarët e tij, janë përdorur epitete të ndryshme si “tradhtar”, “bashkëpunëtorë të nazifashizmit”³¹ etj. Po çfarë në të vërtetë përfaqësonte Balli Kombëtar? Balli ishte një nevojë e domosdoshme e kohës që ndiqte vijën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj dhe bashkimin e Kosovës e Çamërisë me Shqipërinë.³²

Lidhur me datën e krijimit të Ballit Kombëtar ka mendime të ndryshme, por duke u mbështetur në literaturën historiografike dhe në bazë të dokumenteve, mund të konstatojmë se, Balli Kombëtar ka lindur si lëvizje e rezistencës që më 1939.³³ Në lidhje me këtë ju referohemi dy momenteve: në prill të vitit 1939, Mit’hat Frashëri (Lumo Skëndo), kishte formuluar “tetë pikat e nacionalizmit shqiptar”, dhe momenti i dytë, në fillim të qershorit 1939 ishte themeluar një kryesi nga intelektualët* më eminentë të kohës në Tiranë, që ishte institucion mbipartiak dhe luante rolin e një

³⁰ Bislimi, *Formacionet*, 78-79.

* Në disa dokumente të sistematizuar në periudhën e sistemit komunist thuhet: Nuk janë të rralla raste kur anëtarët e Ballit lajmëronin gjermanët për vendndodhjen e forcave partizane, gjithashtu ka edhe raste bashkëpunimi midis tyre. Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë (më tej: AIHT), Fondi (më tej: F.) F.A-VIII, Dosja (më tej: D.) 306, Britania e Madhe dhe Shqipëria, 53, Tiranë, 9 qershor 1972.

³¹ Në shtypin e kohës janë me dhjetëra artikuj ku kërkoheshin të gjithë ata që kanë bashkëpunuar me italianët dhe gjermanët dhe njëkohësisht trajtoheshin të gjithë si kriminelë të luftës, siç ishte Abaz Kupi, Mit’hat Frashëri, Mehdi Frashëri, Rexhep Mitrovica, Xhafer Deva e shumë personalitete të tjera, “*Kriminelët e luftës dhe tradhtarët e popullit duhet të gjykohen në Tiranë*”, Bashkimi, Tiranë, Nr.57, 27 shkurt 1945, 1; “*Në emër të popullit kërkojmë dorëzimin e kriminelëve të luftës*”. Në këtë artikull janë dhënë emrat e personaliteteve të jetës politike që kanë vepruar në hapësirën shqiptare dhe kërkohen nga pushteti i asaj kohe. Bashkimi, Tiranë, 6 mars 1945, fl.3; Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), Fondi (më tej: F.) Komiteti Krahinor i L. K të Kosovës, Njësia Organi: Mjete Propaganduese, Viti (më tej V.) 1935-1945, Nr. i Kutisë 37/1/, fl. 6. Vdekje Fashizmit & Liri Popullit -Tradhtarëve ju dul boja.

³² AQSH, F.270/APL, D.11, V.1943, fl.4, Udhëzimet për sjelljen e anëtarësisë së Ballit Kombëtar, pa datë.

³³ Bislimi, *Formacionet*, 80.

* Mit’hat Frashëri, Thoma Orollgan, Fuad Dibra, Nuredin Vlora, Hasan Dosti dhe Faik Kuku.

komiteti për veprim. Ndërsa, emri i organizatës Balli Kombëtar u paraqit menjëherë pas Konferencës së Pezës** në nëntor të vitit 1942.

Përbërja e Ballit Kombëtar ishte komplekse.*** Në gjenezën e tij gjejmë disa figura me peshë politike, madje, programi i organizatës Balli Kombëtar ishte Dekalogu që është 90% e “tetë pikave të nacionalizmit shqiptar”, të shkruara nga Mit’hat Frashëri në fillim të pushtimit. Në kuadër të Programit-Dekalogut përfshihet mobilizimi i të gjitha forcave të kombit kundër pushtuesit, për realizimin e idealit kombëtar.³⁴

Nga dhjetë pikat e programit të Ballit Kombëtar, po theksojmë vetëm disa prej tyre (pikat 1, 2, 9 dhe 10): 1. luftojmë për flamurin kuq e zi, për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar; 2. luftojmë për Shqipërinë e lirë, etnike e demokratike mbi baza të shoqërisë moderne; 9. luftojmë për të normalizuar dhe bashkuar energjitë e kombit, të përgatisë bashkimin mendor dhe shpirtëror të gjithë shqiptarëve; 10. luftojmë të gjithë kundër pushtuesit për realizimin e idealit të lartë kombëtar.³⁵

Ky program, ishte tejet i avancuar sa i përket përpilimit të kërkesave për zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare shqiptare. Balli Kombëtar kishte Komitetin Qendror dhe Komitetin Qarkor në tërë Shqipërinë sipas ndarjes administrative. Por, ky subjekt arriti të zgjerohej dhe të krijonte degët e tij edhe në Kosovë. Kështu, në Prishtinë në Shkollën Normale “Sami Frashëri”, Balli formoi organet e veta dhe krahas kësaj arriti që të formonte edhe “Rininë balliste” dhe njësitet e armatosura të saj.

** Konferenca e Pezës (16 shtator 1942) u organizua si nevojë e domosdoshme e bashkimit të të gjitha forcave antifashiste shqiptare dhe angazhimi i tyre kundër pushtuesit italian. Deri në këtë periudhë kohore llogariteshin se ekzistonin 22 çeta partizane. Nismën për organizimin e kësaj konference e mori PKSH. Në të u ftuan të gjithë partnerët e të gjitha forcave antifashiste. Në të morën pjesë 18 delegatë. Në këtë takim u diskutua edhe çështja e Kosovës dhe si përfundim u mor që çështja e saj të zgjidhej pas luftës me anë të vetëvendosjes, siç e përcakton Karta e Atlantikut, dhe se këtë të drejtë shqiptarët e Kosovës do ta fitojnë duke u ngritur në luftë kundër fashizmit krah për krah me jugosllavët. Prandaj, Këshilli i Përgjithshëm i NÇSH-së do të jap ndihmën e nevojshme që shqiptarët e Kosovës të organizoheshin në luftë dhe në këtë proces të krijojnë këshillat e veta nacionalçlirimtare. AIHT, A-V, D.297, Nr. In.1977, fl.16. Rezistenca evropiane në vitet e Luftës së Dytë Botërore. *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 57.

*** Ali Këlcyra, Rexhep Mitrovica, Kolë Tromara, Bahri Omari, grupin e dytë e përbënin ata që e kundërshtuan qeverinë fashiste siç ishin Hasan Dosti, Mithat Frashëri etj., ndërsa grupin e tretë në këtë organizatë e përbënin pjesëtarë të grupit komunist “Zjarri”. Më vonë Ballit iu bashkuan anëtarë të PKSH-së dhe të LNÇ-së, si Sadik Premaj, Xhelal Staravecka etj. Bislimi, *Formacionet*, 81.

³⁴ AQSH, F.270/APL, D.11, V.1943, fl.4. Dekalogu i Ballit Kombëtar, 1942.

³⁵ Bislimi, *Formacionet*, 83.

Në kuadër të politikës së jashtme, Balli Kombëtar ishte për një bashkëpunim të ngushtë me fuqitë e demokracitë e mëdha perëndimore. Ky subjekt ishte, po ashtu, për një bashkëpunim të ngushtë dhe të sinqertë me shtetet fqinje, në veçanti me forcat e djathta greke, duke respektuar të dyja palët kufirin e vitit 1913. Ndërsa, sa i përket çështjes së Kosovës, kishte qëndrim të qartë: Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë.

Në kuadër të politikës së brendshme, BK kishte për pikë kryesore të programit stabilizimin e një demokracie të vërtetë ose popullore, siç u arrit në mbledhjen e Mukjes*. Kjo e fundit, ishte padyshim një ndër arritjet më të mëdha politike në periudhën e luftës antifashiste, dhe për këtë arsye formoi Komitetin për Shpëtimin e Shqipërisë (Shqipërisë etnike), ku detyra e parë e këtij Komiteti ishte çështja e proklamimit të pavarësisë. Komiteti

* Konferenca e Mukjes është thirrur në momentet më vendimtare të Luftës së Dytë Botërore, si një domosdoshmëri që e dedikoi koha dhe sidomos e ardhmja e popullit shqiptar. Bashkimi i dy organizatave në luftë kundër pushtuesit u miratua edhe nga ana e drejtuesit të Ballit Kombëtar, të cilët u solidarizuan me mendimin për të qenë pjesëmarrës në Mbledhjen e Mukjes. Pas takimit nga përfaqësuesit e të dyja palëve në Tapizë, më 26 korrik, u vendos që bisedimet t'i vazhdonin në Mukje. Vendimet e Mukjes përbëjnë një pikë kulmore në historinë e Luftës Çlirimtare Antifashiste dhe mund të themi se ishte vazhdimësi e vendimeve të Konferencës së parë, pra asaj të Pezës. Bashkimi i dy organizatave buroi nga vetë karakteri i Luftës nga interesat themelore kombëtare të popullit shqiptar, bashkëpunimi në luftë kundër fashizmit. Ky bashkëpunim kishte filluar që në protestat e 28 Nëntorit të vitit 1941 në Tiranë, ku përveç komunistëve, morën pjesë e folën edhe nacionalistët që më pas u bënë kurrë të organizatës së Ballit. Në mbledhjen e Mukjes u arrit marrëveshja historike për luftë të përbashkët e të menjëhershme kundër pushtuesve fashistë për një Shqipëri të lirë, demokratike, e popullore e për zbatimin e parimit të vetëvendosjes për Shqipërinë etnike. Nuk ka asnjë dyshim se kundër marrëveshjes për bashkimin e popullit shqiptar në luftë ishin pushtuesit fashistë, pastaj emisarët jugosllavë që vepronin në Shqipëri, të cilët i kishin të qarta projektet e PKJ-së ndaj problemit kombëtar të popullit shqiptar, planet për krijimin e Shtabit Ballkanik, që më pas u shoqëruan me një varg veprimesh të tjera që synonin likuidimin e pavarësisë politike të Shqipërisë. Synimet e PKJ-së ishin diametralisht të kundërta me qëndrimin e forcave atdhetare shqiptare si në radhët e Frontit, po ashtu edhe nga ana e Ballit Kombëtar. Pas Marrëveshjes së Mukjes, problemi i pushtetit u bë çmimi tundues, që të kalohej në një përplasje forcash politike, midis vetë shqiptarëve që qëndruan pas këtyre forcave. Sapo mësuam për vendimet e Mukjes, emisarët e PKJ-së pranë PKSH-së, reagueshëm sepse ajo ishte e papranueshme për udhëheqjen jugosllave. Milladin Popoviq ka pranuar vetë se ka ndikuar në PKSH dhe në LNÇ që gjithsesi të prishi Marrëveshjen e Mukjes. Me prishjen e Marrëveshjes së Mukjes mund të themi se u shënuar ndarja përfundimtare e forcave politike në Shqipëri për një organizim të përbashkët kundër pushtuesit të përbashkët. Më gjerësisht shih: AQSH, F.20, D.2, fl.5; Dezhgiu, "Në Mukje bashkimi, pas Mukjes ndarja", Balli Kombëtar, 5 dhjetor 1992; Lefter Nasî, "Kushtet historike dhe politike në të cilat u mbledh Konferenca kombëtare e Mukjes", *Studime historike*, Viti XLVI/1992:Nr.1-4, 70.

do të caktohej më së largu më 8 gusht, dhe se ndërkohë detyrat e këtij Komiteti do të ushtroheshin prej një Komiteti provizor të përbërë nga 12 veta, nga 6 prej të dyja palëve.³⁶ Përtej kundërshtimeve të vogla për sa i përket çështjes së Kosovës, në Mukje u miratua parimi i njohur universal i vetëvendosjes së popujve që është garantuar nga Karta e Atlantikut më (gusht 1941), që nënkuptonte parimin e vetëvendosjes së popullsisë shqiptare për krijimin e një Shqipërie etnike. Ky formulim ishte në përputhje me idetë e Kartës së Atlantikut, ide që në atë kohë propagandohej edhe nga PKJ dhe si rrjedhojë marrëveshja e Mukjes nuk do të duhej të krijonte asnjë problem me Aleatët dhe as me jugosllavët.³⁷

Por, me t'u njoftuar për arritjen e marrëveshjes së Mukjes (8 gusht 1943), të dërguarit e PKJ-së, Milladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha, në Komitetin Qendror të PKSH-së, kundërshtuan ashpër këtë marrëveshje, duke thënë se: "Marrëveshja e Mukjes është në kundërshtim me parimet e përgjithshme për internacionalizimin dhe kahun e luftës klasore kundër okupatorit dhe bie në kundërshtim me vijën e përgjithshme të PKJ-së. Andaj si e tillë kjo marrëveshje duhet të priset".³⁸

Të ndikuar dhe mbase të frikësuar nga përfaqësuesit e PKJ-së, që nga shtatori i vitit 1943, PKSH shprehte hapur kundërshtinë ndaj Ballit, andaj filloi të përhapte lajmin se Marrëveshja e Mukjes është prishur. Arsyeja për këtë qëndrim të PKSH-së, ishte se gjoja Balli Kombëtar nuk bëri aksione të armatosura kundër okupatorit. Por, po të mbështetemi në dokumentet e kohës dhe në arritjet e historiografisë shqiptare vijmë në një përfundim tjetër, duke argumentuar kështu faktin se, Balli ka bërë aksione në çdo kohë edhe para Marrëveshjes së Mukjes³⁹. Për prishjen e Marrëveshjes së Mukjes ndikim të drejtpërdrejtë pati i deleguari i KQ PKJ-së për Ballkanin, Svetozar Vukmanoviq -Tempo, i cili gjatë muajve qershor-gusht 1943 pati disa takime me kreun e PKSH-së. "...Unë u fola se duhet filluar luftën politike kundër Ballit Kombëtar...", shkruante ndër tjerave, Tempo në raportin që ai më 8 gusht 1943 ia dërgoi KQ të PKJ-së, lidhur me aktivitetin e tij disamujor në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri.⁴⁰ Me anulimin e Marrëveshjes së

³⁶ Bislimi, *Farmacionet*, 85.

³⁷ *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 69.

³⁸ AQSH, F.20, D.2, fl.4-5; Masar Sopoti, "Vullneti i fisit", Bashkimi i kombit, fl1. Tiranë, 21 qershor 1944; Shatri, *Kosova*, 105-115; Golemi Zaho & Aurora Golemi, "Shtabi i Përgjithshëm dhe roli i tij për shndërrimin e UNÇSH-së në ushtri të rregullt", *Studime për historinë ushtarake*, Nr.6/2013, 56.

³⁹ Bislimi, *Formacionet*, 87.

⁴⁰ Tokat e liruara 1941-1944, Përmbledhje dokumentesh, Vëll. 2, përzgjedhjen, përkthimin, redaktimin dhe hyrjen, Qerim Lita, Logos-A, Shkup, 2016, dok. nr. 417, f. 368-369, Raport

Mukjes, PKSH-së dëshmoi se ishte e vendosur të mos e ndante pushtetin me asnjë forcë tjetër politike. Të njëjtin qëndrim mbante edhe Balli Kombëtar, i cili zotohej se do të hidhte forca në luftë, ndonëse sipas komunistëve realisht nuk ishte as i përgatitur dhe as i gatshëm ta bënte një gjë të tillë. Në këtë mënyrë të dy forcat politike, PKSH dhe BK, nuk arritën të gjenin gjuhën e mirëkuptimit e të bashkëpunimit dhe kësisoj në vend të bashkimit të forcave, ato u ndanë, ndarje që kishte pasoja në organizimin e luftës dhe pasluftën.⁴¹

Me qëllim të arritjes së unitetit u thirr Kuvendi i Lurës, që u mbajt më 27 gusht 1943, në krye me Mit'hat Frashërin e Abaz Kupin, ku morën pjesë 61 përfaqësues që ishin në përpjekje për ta vazhduar frymën e Mukjes, atë të bashkimit pa dallim krahine, bindje politike, feje dhe që të luftonin kundër pushtuesit.⁴²

Komiteti Qendror i PKJ-së nuk mund ta pranonte një Shqipëri etnike dhe të mirorganizuar. Atij i duhej një Shqipëri që ta përdorte si marionetë për qëllimet e veta politike, deri në përfshirjen e saj në kuadrin e shtetit jugosllav. Prandaj, jugosllavët e zgjeruan fushatën përçarëse në të gjitha trojet e Shqipërisë etnike. Së pari, në Konferencën e Dytë të Labinotit, më 4 shtator 1943, Mukja u denoncua zyrtarisht, me tezën se pushteti i Këshillave të LNÇ-së është i vetmi pushtet i popullit. Në trojet jashtë Shqipërisë politike, për popullin serb çdo gjë që nuk ishte në pajtueshmëri me qëllimet dhe karakterin e luftës çlirimtare serbe, ishte nacionaliste, armiqësore, fashiste dhe si të tilla duhet të luftoheshin deri në zhdukje.⁴³

Por, planet e komunistëve e kishin përjashtuar Ballin plotësisht nga skena politike. Për të gjithë ata që kishin mëdyshje u vu alternativa "O me ne, o kundër nesh". Kjo ndikoi që të humbej shpresa e shumëpritur për luftën e përbashkët antifashiste.⁴⁴ Në periudhën kohore kur lufta kundër pushtuesve zhvillohej me përmasa të gjëra në të gjitha trojet shqiptare, Balli Kombëtar mbajti Kongresin e Parë në Berat nga 1 deri më 3 janar 1944, ku të pranishëm ishin 74 delegatë të cilët zgjodhën Komitetin Qendror të Ballit Kombëtar*. Si rezultat i gjendjes së krijuar, tema kryesore ishte se si të

nga Svetozar Vukmanoviq - Tempo, dërguar më 8 gusht 1943 KQ të PKJ-së, mbi aktivitetin e tij tetë mujor në Serbinë Jugore, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri dhe Greqi.

⁴¹ *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 71.

⁴² Bislimi, *Formacionet*, 88.

⁴³ Bislimi, *Formacionet*, 87.

⁴⁴ ASHAK. F. Komiteti Krahinor i L. K të Kosovës, Njësia organi: Mjetet për propagandë, V.1941-1945, Nr. K. 37, Balli Kombëtar gënjeu.

* Këshilli Qendror i Ballit Kombëtar përbëhej nga: Mithat Frashëri, Vasil Andon, Abaz Ermenji, Zef Pali, Koço Muka, Skënder Muça, Ali Klisura (Këlcyra) dhe Kadri Cakrani.

shpëtohej lufta civile në vend dhe t'i jepej fund pushtuesit. Që nga mesi i vitit 1944, Balli u gjend në luftime në dy fronte: në atë kundër pushtuesve dhe në atë kundër ideologjisë komuniste "luftës së klasave". Andaj, Balli u dobësua dhe nuk ishte më organizatë që mund të funksiononte. Megjithëse në Shqipëri, Balli Kombëtar kishte formuar njësitet e veta të armatosura dhe zhvillonte luftime të rrepta në disa vise të Shqipërisë, në Kosovë, nacionalizmi ishte në nivelin e informimit dhe të propagandës, të ringjalljes së ndjenjës nacionale, nëpërmjet njerëzve të Ballit.⁴⁵

Në bazë të të dhënave historike, me të drejtë mund të konstatojmë se, Balli Kombëtar në Kosovë deri në vitin 1943 nuk kishte arritur të formohet si organizatë me emrin Balli Kombëtar. Por, i tërë aktiviteti kombëtar zhvillohej me formimin e grupeve dhe të partive të reja politike shqiptare. Sipas historiografisë serbe, veprimtaria e nacionalizmit shqiptar në të gjitha trojet shqiptare paraqitet me emrin Balli Kombëtar dhe me qëllim të caktuar politik, e përkufizuar me fillimin e vitit 1941, pa bërë të njohur veprimtarinë e partive të tjera shqiptare që vepruan me programe kombëtare gjatë tërë Luftës së Dytë Botërore.

Bërthamën e BK-së në Kosovë, e cila në aktin e themelimit, në përbërje të vet, kishte edhe Komitetin e Rinisë Balliste, e formoi Vasil Andoni, në fund të shtatorit 1943. Ky akt ishte një përpjekje e filluar në fund të vitit 1941 në Normalen "Sami bej Prishtina", në emër të nacionalizmit shqiptar si Lëvizje e Rezistencës kundër pushtuesve. Në përbërje të këtij komisioni ishin: Vasil Andoni, Luan Gashi, Ali Gashi, Xhavit Veseli, Selman Krasniqi dhe Ali Riza Roka.⁴⁶ Në përgjithësi, gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë, personalitetet më të njohura të Ballit Kombëtar në Kosovë ishin: Hasan Dosti, Qazim Bllaca, Faik Quku, Halim Spahiu, Tahir Deda, Kolë Margjini etj. Një ndër aktivistët më të dalluar të Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishte Selman Riza*, i cili që në vitin 1942-1943 veproi hapur kundër pushtuesit, por njëkohësisht ishte edhe kundër kthimit të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë.⁴⁷ Riza botoi një traktat me përmbajtje

Shin në; Bislimi, *Formacionet*, 89.

⁴⁵ Bislimi, *Farmacionet*, 90.

⁴⁶ Bislimi, *Farmacionet*, 90-94.

* Selman Riza, 1909, kreu Fakultetin e Letërsisë dhe Drejtësisë në Francë. Për shkak të demonstratave në Tiranë, italianët e burgosen dhe e dërguan në Ventotene të Italisë. Në Kosovë veproi që nga viti 1942. Nga serbët ndiqej si nationalist, ndërsa në Shqipëri e arrestuan si antijugosllav. Si një veprimtar i dalluar prof. Selmani përfundoi në mënyrë të heshtur si një ciceron në Muzeun e Beratit. Më gjerësisht shih: Bislimi, *Farmacionet*, 93.

⁴⁷ AIDSSH, F.6, D.128. Raport mbi Kosovën. Tiranë, 1946.

programatike, kundër nazifashizmit dhe pro idesë që Kosova duhej të bashkohej me Shqipërinë.⁴⁸

Shkolla “Sami bej Frashëri” në Prishtinë ishte institucioni më i përshtatshëm dhe më i rëndësishëm i Ballit Kombëtar për propagandimin e ndjenjës nacionaliste përparimtare dhe për themelimin e organizatës së Ballit Kombëtar në Kosovë. Angazhimi për nxitjen dhe kultivimin e ndjenjës nacionaliste në Shkollën Normale të Prishtinës, ishte i rëndësishëm edhe për shkak se kuadri i mësimdhënësve dhe i nxënësve ishte prej të gjitha trojeve shqiptare. Kjo ishte një mundësi shumë e mirë për angazhimin e veprimtarisë propaganduese për Shqipërinë etnike dhe organizimin e rezistencës.⁴⁹ Për shkak të rrethanave të vështira që impononte okupatori dhe qeveria e Nediqit, profesorët, nationalistët dhe nxënësit e Normales “Sami bej Frashëri”, së bashku me përfaqësuesit e ideologjisë komuniste të rreshtuar në frontin e përbashkët antifashist, në mars të vitit 1943, organizuan demonstrata kundër okupatorit në qendër të Prishtinës. Pas përfundimit të protestës xhandarmëria fashiste ushtroi dhunë ndaj popullsisë civile. Njëkohësisht ndërmoi një fushatë të ashpër kundër demonstruesve, ku burgosi disa persona të cilët jo vetëm që ishin ithtarë të nacionalçlirimtares, por dhe ithtarë të Ballit Kombëtar.⁵⁰

Balli Kombëtar zhvilloi aktivitetet e tij edhe në territorin e Dukagjinit sidomos në vendbanimet në afërsi të Shqipërisë. BK kishte ithtarët e vet, të cilët në dhjetor të vitit 1943, kishin arritur të organizoheshin në nivel grupesh, qëllimi i të cilëve ishte mbajtja e lidhjeve me organizatën e Ballit Kombëtar në Kukës dhe në Malësinë e Shkodrës. Në qytetin e Pejës u organizua një qendër e BK-së, e cila ishte mjaft e fuqishme. Kjo qendër udhëhiqej nga Haris Thanasi dhe Hasan e Tefike Begolli, ndërsa bashkëpunëtorë të kësaj qendre ishin Muharrem Bajraktari dhe Ramë Muja.

Me gjithë organizimin e Ballit në Kosovë, pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë*, i udhëhequr nga Pavle Joviqeviq, sekretar, zhvilloi një fushatë të gjerë ndëshkuese dhe terroriste ndaj njerëzve dhe ithtarëve të Ballit Kombëtar në tërë territorin e Kosovës, e më gjerë.⁵¹ Duke ia bërë të pamundur veprimin

⁴⁸ Bislimi, *Farmacionet*, 90-94.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty, 95.

* Udhëheqja e PKJ-së në korrik të vitit 1943 Komitetin e Qarkut për Kosovë e avancoi në Komitet Krahinor, shih më gjerësisht, Izber Hoti, *Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*, “Ora”, 31, 17 maj 1996, 46.

⁵¹ Gazeta “Liria”, organ i Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Dukagjinit, nr. 12-14, fl.7. Nëntor 1943- Janar 1944, Fjalimi Pavle Jeviceviq (Përfaqësues i Komitetit Krahinor

me të njëjtin emër, nacionalizma progresive shqiptare, në rrethanat e krijuara në trojet jashtë kufijve të Shqipërisë së cunguar, filloi të vepronte me emër tjetër “Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare” (NDSH).⁵² Sipas të dhënave që na ofron historiografia dhe që janë bindëse, NDSH-ja e vitit 1945 është vazhdim i Komitetit Nacional Demokratik të Ejup Binakut, formuar pas Mukjes nga vjeshta e vitit 1943, në shtëpinë e Gani Radoviqit në Gjakovë. Në rrethanat e krijuara, NDSH-ja zhvilloi aktivitetet e saj jashtë Shqipërisë politike në harkun kohor, 1945-1951.⁵³

Lidhja e Dytë e Prizrenit - ndryshe nga Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe disa grupime nga radhët e nacionalistëve, që qenë angazhuar në luftë kundër pushtuesve nazifashistë, forcat kryesore nacionaliste hezitnin ta bënë të njëjtën gjë, t’u bashkoheshin atyre, pasi mendonin se një luftë që udhëhiqej nga komunistët do të përfundonte me rivendosjen e pushtetit jugosllav në Kosovë. Nacionalistët gjermanë e shihnin si të keqen më të vogël në krahasim me sundimin serb e jugosllav që pritej të rivendosej pas tërheqjes së tyre. Pikërisht për këtë arsye, pas kapitullimit të Italisë, ata përpunuan idenë e thirrjes së një kuvendi kombëtar, i cili duhej të hidhte bazën e krijimit të një organizate politike, që do të mbronte trojet etnike nga rreziku i ripushtimit të Kosovës nga forcat jugosllave, pas largimit të trupave gjermane.⁵⁴

Ideja për formimin e organizatës Lidhja e Dytë e Prizrenit u hodh më 11 shtator 1943, datë në të cilën u mbajt një mbledhje që themeloi Këshillin Organizativ, i cili përbëhej prej 8 vetash, të gjithë personalitete të njohura të jetës publike.** Këta tetë persona u ngarkuan për organizimin e Kuvendit si dhe për krijimin e komiteteve përkatëse në të gjitha prefekturat, nënprefekturat dhe komunat, si dhe dhanë udhëzimet e nevojshme për zgjedhjen e përfaqësuesve të këtyre trevave.⁵⁵ Kuvendi u mbledh në Prizren, dhe i zhvilloi punimet nga 16 deri më 20 shtator 1943. Në këtë Kuvend morën pjesë 45 delegatë të zgjedhur nga Kosova dhe trevat e tjera shqiptare. Në këtë Kuvend u vendos formimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit,

i PKJ-së për Kosovë dhe Dukagjin) në Mbledhjen e Këshillit Nacionalçlirimtar të datës 31 dhjetor 1943.

⁵² Bislimi, *Farmacionet*, 95.

⁵³ Po aty, 96.

⁵⁴ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në luftë, 1939-1944*, Tiranë: Globus R, 2001, 310-311.

** Anëtarët e Këshillit Organizativ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishin: Musa Sherazade që mori përsipër organizimin e Kuvendit dhe njëkohësisht ushtronte pozitën e Kryetarit, Lukë Simon Mjeda, Sheh Hasani, Pjetër Vuçaj (Prizren) Xhafer Deva, A. Boletini (Mitrovicë), Tahir Zajmi (Gjakovë) dhe Qazim Bllaca (Suharekë).

⁵⁵ Shatri, *Kosova*, 188-189.

që ishte organizatë politike kombëtare, e cila do të angazhohej për bashkimin dhe mbrojtjen e trojeve etnike. Për drejtimin e punimeve u zgjodh kryesia prej katër anëtarëve në përbërje prej Musa Shehzades (kryetar), Aqif Blyta e Rexhep Krasniqi (nënkryetarë) dhe Bedri Gjinaj (sekretar).⁵⁶ Kuvendi zgjodhi Këshillin Qendror të Lidhjes të përbërë prej 7 anëtarësh: Rexhep Mitrovica (kryetar), Musa Sherzade (nënkryetar) dhe anëtarët Tahir Zajmi, A. Boletini, K. Margjini, Sh. Hasani, Q. Bllaca. Po ashtu, Kuvendi miratoi edhe procedurën e zgjedhjes së delegatëve që do të përfaqësonte këto treva në Asamblenë Kombëtare, që do të thirrej në Tiranë më 16 tetor 1943, dhe shtoi nevojën e hartimit të Statutit të Organizatës. Kuvendi autorizoi Xhafer Devën, Aqif Blytën dhe Ibrahim Lutfiun për të koordinuar punët e Lidhjes me atë të qeverisë shqiptare, për çështjen e Kosovës.⁵⁷ Me propozimin e Tahir Zajmit, Kuvendi Themelues proklamoi bashkimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare me Shqipërinë, si pjesë integrale e saj dhe kërkoi bashkimin me të edhe të qarkut të Mitrovicës që i takonte zonës gjermane të pushtimit.⁵⁸

Në mbledhjen themeluese, delegatët shfaqën kërkesat e tyre në lidhje me prefekturat të cilat përfaqësonin, duke kërkuar bashkimin e tyre me Shqipërinë. Vlen të përmenden delegatët si Esat Berisha, që përfaqësonte rajonin e Gjilanit (Anamoravën), delegati i Rugovës, Sali Rama etj. Në këtë kuvend u trajtua edhe çështja e organizimit politik dhe ushtarak, marrja e masave mbrojtëse kundër depërtimit në këto treva, si të forcave çetnike dhe të atyre partizane nga Mali i Zi dhe Serbia.⁵⁹

Kuvendi i Dytë i Lidhjes së Dytë të Prizrenit i zhvilloi punimet më 17-21 janar të vitit 1944, në të cilin bënë ndryshime në Kryesinë e Lidhjes. Kryetar i Komiteti Qendror u zgjodh Bedri Pejani, pasi Rexhep Mitrovica ishte emëruar kryeministër i qeverisë që gjermanët e krijuan në Tiranë.⁶⁰ Po ashtu, në këtë kuvend përveç të tjerash u vendos që në përputhje me Statutin e organizatës, të zgjerohet Këshilli Qendror nga 7 në 14 anëtarë*, me në krye Bedri Pejanin.

⁵⁶ Shatri, *Kosova*, 188-189.

⁵⁷ Po aty, 189.

⁵⁸ “Zani i fuqishëm i Rinisë Nacionaliste për Kosovën e sulmuese” Bashkimi i kombi, Viti II, Nr. 137, 13 qershor 1944, fl.1.

⁵⁹ Shatri, *Kosova*, 189.

⁶⁰ *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 139.

* Anëtarët e Këshillit Qendror ishin: Bedri Pejani (kryetar), K. Margjini dhe Musa Shehzade (nënkryetarë), Bedri Gjinaj (sekretar) dhe anëtarë të këtij kuvendi ishin: Tahir Zajmi, Xh. Begolli, N. Basha, E. Berisha, A. Boletini, M. Agolli, Ekrem Jegeni, Rexhë Metaj, M. Begolli dhe S. Ashqia. Nën varësinë e Këshillit Qendror ishte Sekretariati, si dhe

Këshilli Qendror bëri përpjekje të organizonte formacionet vullnetare që do të mbronin trevat kufitare shqiptare si rajonin e Rozhajës, të Plavës, të Gucisë, të Gjilanit etj. Ndër kërkesat kryesore të këtij Kuvendi drejtuar qeverisë, ishin: që të angazhohej rreth çështjes së Sanxhakut, të ndërmarrë hapa diplomatikë në mënyrë që të siguronte largimin e trupave bullgare nga Prespa dhe Shën Naumi; që pjesa e Mitrovicës t'i bashkohet Shqipërisë; të forconte administratën e saj në krahinën e Plavës dhe të Gucisë dhe të merrte masa të ngutshme organizative dhe ushtarake në të gjitha trevat shqiptare që iu bashkuan Shqipërisë.⁶¹ Në Kuvendin e Dytë të Lidhjes së Dytë të Prizrenit po ashtu u kërkuar nga qeveria e Tiranës, rregullimi dhe hapja e rrugëve që lidhnin Thethin me Gucinë, Radavcin me Rozhajën, Kolesjanin dhe Peshkopinë, Tetovën me Prizrenin, pastaj të vendoseshin edhe linjat telefonike. Në kuadër të kërkesave të Kuvendit drejtuar qeverisë në Tiranë ishte edhe zgjerimi i rrjetit të shkollave fillore në këto treva, në mënyrë të veçantë në Kosovë.⁶²

Kuvendi, më 21 janar 1944, miratoi statutin e Lidhjes i cili iu dërgua qeverisë dhe Këshillit të Naltë në Tiranë për aprovim dhe dekretim. Statuti u dekretua më 14 mars të vitit 1944 dhe kishte 22 nene.⁶³ Ajo do ta kishte edhe organin e vet të quajtur "Lidhja e Prizrenit", në faqet e të cilit propagandohej ideja e krijimit të Shqipërisë etnike dhe denoncoheshin krimet e kryera nga serbët ndaj shqiptarëve të Kosovës. Në nenin Nr.1, pasqyrohej çështja e themelimit, organizimit dhe funksionimit të Lidhjes, ndërsa në nenin Nr.2, parashtrohen kompetencat dhe qëllimet e saj, të cilat konsistojnë para së gjithash në mbrojtjen e trevave të çliruara, si dhe çlirimin e viseve të tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Për realizimin e këtyre qëllimeve, Lidhja do të punonte si në organizimin ushtarak, atë politik, si dhe në propagandimin e nevojës për ruajtjen e Shqipërisë etnike.⁶⁴ Kështu, krahas organeve qendrore, në prefektura u formuan komitetet dhe qarqet me nga 7 anëtarë; në nënprefektura komitetet e rretheve me 5 anëtarë; në komuna, komitetet e komunave me nga 3 anëtarë

Seksioni Financiar, Kulturo-Arsimor dhe ai Ushtarak. Shih në: Shatri, *Kosova*, 188.

⁶¹ "Zani i fuqishëm i Rinisë Nacionaliste për Kosovën", *Bashkimi i Kombit*, Tiranë, Nr.137, 13 qershor 1944, fl.1.

⁶² "Djelmënija e Nacionalistes Vullnetare e Kryeqytetit priti me lot gëzimi nga Populli i Kosovës", *Bashkimi i kombit*, Tiranë, 21 qershor 1944. fl. 1-2.

⁶³ AQSH, *Fletorja zyrtare*, Nr.12, 17 mars 1944, fl.3. Aprovimi i statutit të organizatës Lidhja II e Prizrenit.

⁶⁴ "Zani i fuqishëm i Rinisë Nacionaliste për Kosovën", *Bashkimi i kombit*, Tiranë, Nr.137, 1, 13 qershor 1944.

dhe në fshatra, komitetet e fshatrave. Komiteti Qendror u formua në Prizren, Prishtinë dhe në Pejë.⁶⁵

Përpjekjet e Lidhjes për organizimin e ushtrisë - në aspektin ushtarak, Lidhja e Dytë e Prizrenit do të bashkëpunonte me qeverinë shqiptare, e cila ishte nën varësinë e gjermanëve. Më 8 janar 1944, Komanda Gjermane lejoi riorganizimin e ushtrisë shqiptare. Me këtë rast u riaktivizua sektori ushtarak në Prishtinë, mandej edhe në Prizren.⁶⁶ Sektori ushtarak i Kosovës varej nga Komanda Gjermane e pushtimit jo vetëm në aspektin e koordinimit, por edhe për furnizimin me ushqim, uniforma dhe pajisje ushtarake.⁶⁷

Me qëllim të riorganizimit të formacioneve ushtarake, Këshilli Qendror i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në bashkëpunim me Komandën e Sektorit Ushtarak të Kosovës organizoi, prej 15-17 mars 1944, në fshatin Rugovë të Hasit një konferencë që kishte për qëllim riorganizimin ushtarak. Në këtë konferencë morën pjesë Bedri Pejani, nga dy anëtarë të komiteteve qarkore të Lidhjes, komandanti i sektorit ushtarak të Kosovës, Q. Komani, krerë dhe bajraktarë nga mbarë Kosova, si dhe dy oficerë gjermanë.⁶⁸ Në këtë tubim u miratua projekti i organizimit ushtarak të Kosovës. Në bazë të këtij projekti parashikohej mobilizimi i formacioneve dhe i rekrutëve prej moshës 20-50 vjeç dhe kategorizimi i tyre. Në kategorinë e parë bënin pjesë të mobilizuarit nga mosha 20-35 vjeç, e cila njihej me emrin “Fuqia Kreshnike”. Kjo kategori u vu nën komandën e drejtpërdrejtë të Komandës së Sektorit të Kosovës dhe ishte e organizuar sipas modelit të ushtrisë së rregullt të ndarë në dhjetëshe, togje, kompani dhe batalione.* Në kategorinë e dytë bënin pjesë vullnetarët, të cilët i përkisnin moshës 35-50 vjeç. Ata aktivizoheshin vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe udhëhiqeshin nga paria e vendit.⁶⁹ Komanda Gjermane duke shpresuar se këto forca mund të

⁶⁵ Shatri, *Kosova*, 191.

⁶⁶ Po aty, 192. Ky sektor kishte dy regjimente. Regjimenti I me seli në Pejë dhe Regjimenti IV në Prishtinë. Çdo regjiment përbëhej nga tri batalione me nga tri reparte varësie në qendrat dhe në pikat e ndryshme kufitare.

⁶⁷ AQSH, F.41/AP, V.1944, D.24, fl.1-6. Raport nga Shkodra, dërguar Shtabit të Përgjithshëm të FNÇSH-së, në të cilën përshkruhet situata politike e ushtarake në Kosovë, Mirditë, Shkodër etj. Shkodër, tetor 1944.

⁶⁸ Shatri, *Kosova*, 193.

* Kompania e kreshnikëve kishte 100 persona, prej të cilëve zgjidhej komandanti dhe 2 zëvendëskomandantë, 4 kapterë dhe 10 tetarë. Njëqind tetarë përbënin një kompani, kurse katër kompani përbënin një batalion. Pjesëtarët e këtyre kompanive qëndronin nëpër shtëpitë e tyre në rast nevojë ata ishin të obliguar që t'u përgjigjeshin thirrjes së komandës ushtarake më të afërt që të mobilizoheshin.

⁶⁹ “Zani i fuqishëm i Rinisë Nacionaliste për Kosovën”, Bashkimi i kombit, Tiranë, Nr.137,

përdoreshin për nevojat e saj, nuk e pengoi organizimin e tyre. Por, duke mos pasur besim tek këto formacione, dhe duke menduar se këto mund t'u ktheheshin edhe kundër, ata nuk e ndihmuan dhe nuk e furnizuan me armatim.⁷⁰

Por, pa marrë parasysh përgjigjen negative që përfaqësuesit e Lidhjes morën nga Komanda Gjermane, përpjekjet e tyre për armatosjen e shqiptarëve nga Gjermania nuk u ndalën. Mjafton të japim letrën që Bedri Pejani, në cilësinë e kryetarit të Komitetit Qendror të Lidhjes, i dërgoi në mars 1944, Hitlerit me të cilën kërkonte që qeveria gjermane të ndihmonte në militarizimin e popullsisë shqiptare të Kosovës. Në letrën e Bedri Pejani, ngrihej lart roli i Gjermanisë në çlirimin, sipas tij, të Kosovës dhe realizimin e aspiratave të popullit shqiptar për bashkim kombëtar.⁷¹ Kryetari i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, kërkoi që Komanda Gjermane të angazhohej në organizimin e një armate me 120 000 deri 150 000 luftëtarë, e cila do të vepronte si kundër çetnikëve, ashtu edhe kundër partizanëve serbo-malazezë.^{**} Bedri Pejani shpresonte që pas armatimit të popullsisë shqiptare, mund të ruhej gjendja e kufijve ekzistues të vendosur nga Fuqitë e Boshtit, deri në mbarim të luftës, me qëllim që pas përfundimit të saj, në Konferencën e Paqes, çështja e përcaktimit të kufijve të vihej para aktit të kryer.⁷² Këtë iniciativë të Bedri Pejani, Komanda Ushtarake Gjermane, përkatësisht gjenerali i plotfuqishëm gjerman me seli në Tiranë, e pëlqeu idenë e formimit të formacionit të një force efektive ushtarake në Kosovë, andaj i rekomandoi Rajhut gjerman që ta miratonte atë.⁷³

Ndonëse nuk është përkrahur plotësisht kërkesa e Bedri Pejani, megjithatë u arrit një marrëveshje midis kryetarit të Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe komandantit të divizionit "Skënderbeg", kolonel Shmith Huber, sipas së cilës ky njësit duhej të operonte në Kosovë

1, 13 qershor 1944. Në këtë shkrim jepen edhe emrat e 400 personave të cilët ishin të gatshëm që të vdisnin për Shqipërinë etnike.

⁷⁰ Hakif Bajrami, *Tragjedia e Tivarit*, Prishtinë: 1993, 63-67.

⁷¹ Dezhgiu, *Shqipëria*, 310-311.

^{**} Deri në këtë periudhë kohore kishin ndodhur me dhjetëra sulme të çetnikëve ndaj popullsisë shqiptare, andaj edhe kërkesa e tij mund të themi se kishte qëllim vetëmbrojtjeje ndaj çetnikëve serbo-malazezë.

⁷² *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. IV, 139.

⁷³ Shatri, *Kosova*, 194. Sa i përket kërkesës së Bedri Pejani, dr. Herman Neubahueri ishte kundër formimit të efektivëve të fuqishëm ushtarak të shqiptarëve, pasi sipas tij, një veprim i tillë nuk do t'i shkonte përshtat bashkëpunimit me qeverinë kuislinge të Serbisë. Megjithatë, Neubahueri arriti ta bindë për nevojën e formimit të një divizioni, dhe në qoftë se kjo do të shkonte mbarë do të formonte një korparmatë.

dhe në trevat e tjera shqiptare.

Në përbërje të divizionit parashikohej të përfshiheshin ushtarët shqiptarë të internuar në Gjermani, që kishin qenë në ushtrinë e Mbretërisë së Jugosllavisë, të rinjtë nga qarku i Kosovës, si dhe pjesëtarët e reparteve të ish-milicisë vullnetare shqiptare (Korpusit të Mbrojtjes së Shtetit).⁷⁴ Dhe pavarësisht thirrjeve të shumta dhe angazhimeve të Komandës XXI, Armatës II, të blinduara në Lidhjen e Dytë të Prizrenit, afatet kohore nuk ishin marrë seriozisht, dhe vetëm një grup i vogël njerëzish iu përgjigjën thirrjes. Radhët e këtij formacioni nuk ishin plotësuar. Rekrutimi kishte nisur prej 25 shtatorit 1944 si në vijim: 11 398 burra, prej të cilëve 9 275 ishin të aftë për të nisur shërbimin. Prej tyre, aktualisht u rekrutuan 6 491 ushtarë. Kryetarët e qyteteve dhe qytezave nuk ndërmorën asgjë, për t'i detyruar ata që ishin në listë, t'i përgjigjeshin thirrjes. Pjesa më e madhe e popullsisë e interpretuan këtë reagim pasiv të kryetarëve dhe prefektëve si ftesë për ta marrë formimin e Divizionit si diçka jozyrtare dhe e parëndësishme, dhe thjesht që të injorohej.⁷⁵

Pasi nuk pati mundësi të siguronte efektivitetin e nevojshëm për kompletimin e njësitit, por edhe për shkak të dezertimeve masive, me urdhrin e komandës gjermane të 24 tetorit 1944, divizioni u riorganizua në grupe luftarake. Ky grup në pikëpamje taktike operative ishte nën komandën e Korparmatës XXI, që ishte e obliguar t'i pajiste me armë dhe me mjete të tjera të nevojshme transportuese. Grupi në fjalë mori pjesë në luftimet përgjatë vijës mbrojtëse të Grup Armatës "E" që po tërhiqej nga Kosova, duke shpresuar se do të ndihmonte në mbrojtjen e trevave etnike shqiptare.⁷⁶ Po ashtu, në fillim të vitit 1944, Lidhja kishte themeluar edhe Komitetin e Rinisë Nacionaliste, që kishte si qëllim mbrojtjen e atdheut dhe të kombit shqiptar**. Këshilli Qendror i Rinisë formoi katër seksione:

⁷⁴ Shatri, *Kosova*, 195.

⁷⁵ Augustin Schmidhuber, "Raport përmbledhës rreth formimit të Divizionit "Skanderbeg" të SS-së (II)", Koha Ditore, Prishtinë, 5 tetor 2016, f.8. Fejton. Më gjerësisht për origjinën e këtij dokumenti: ky dokument ishte përpiluar nga komandanti gjerman i Divizionit të sipërpërmendur shqiptar të SS-së, August Schmidhuber (1901-1947), nga Augsburgu në Bavari, më 2 tetor të 1944, pak para tërheqjes gjermane nga Shqipëria, në nëntor të 1944. Ky Divizion i SS, me rreth 6 000 pjesëtarë, u formua nga nazistët (rekrutimi filloi në shkurt të 1944 dhe e mori emrin në gusht të 1944). Ai kurrë nuk e mbërriti kapacitetin operativ, teksa u shpërnda më 1 nëntor të vitit 1944, ndonëse deri atëherë, shumica e rekrutëve kishin dezertuar dhe ikur. Gjeneralmajori Schmidhuber më vonë u shpall fajtor për krime lufte prej një Tribunali Ushtarak jugosllav (më 27 shkurt të 1947 në Beograd) dhe u var në nëntor të 1947.

⁷⁶ Shatri, *Kosova*, 196.

** Mbledhja themeluese e "Komitetit të Rinisë" është mbajtur në ndërtesën e Gjymnazit

seksionin ushtarak, politik, ekonomik dhe propagandistik, e cila kishte për detyrë të luftonte për mbrojtjen e vendit dhe për ruajtjen e integritetit tokësor nga sulmet e jashtme që synonin ndarjen e Shqipërisë etnike.⁷⁷

Kuvendi i Tretë i Lidhjes së Dytë të Prizrenit i zhvilloi punimet më 19 qershor 1944, në rrethana të jashtëzakonshme dhe tejet të vështira, nëpër të cilat kalonin shqiptarët në fund të Luftës së Dytë Botërore. Kjo ishte arsyeja që munguan përfaqësuesit e viseve shqiptare të Plavës, Gucisë dhe të Rozhajës.* Ndër vendimet kryesore të këtij kuvendi ishte shkarkimi i Bedri Pejanit dhe zëvendësimi i tij nga Xhafer Deva, që u zgjodh me direktivat e gjermanëve. Kuvendi vendosi edhe riorganizimin e seksioneve që ishin nën varësinë e Xhafer Devës.⁷⁸ Kështu, për Seksionin Ushtarak u ngarkua A. Boletini, Seksionin Financiar R. Meta, Seksionin Ekonomik Sh. Basha, Seksionin e Rinisë B. Gjinaj etj. Po ashtu, në këtë kuvend u vendos edhe angazhimi i Lidhjes dhe i Këshillit Qendror të saj për të mbrojtur Kolashinin dhe sektorët e tjerë që rrezikonin depërtimin e forcave çetniko-partizano-serbo-malazeze.

Në Kuvendin e Tretë të Lidhjes së Dytë të Prizrenit është konstatuar se ajo ka ndërmarrë hapa konkretë në bashkëpunimin dhe koordinimin me krahinat e tjera të Shqipërisë, në mënyrë të veçantë me Malësinë e Mbishkodrës, të Dibrës me në krye Cen Elezin dhe të Matit me në krye Abaz Kupin, të cilët ishin vënë drejtpërdrejt në shërbim të çështjes së Kosovës.⁷⁹ Kuvendi shtroi nevojën e armatimit të mëtejshëm të popullit të Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare, dhe vuri si prioritet themelimin e regjimenteve të reja krahas Pejës dhe Prishtinës, të formoheshin dhe në Tetovë e Dibër. Po ashtu, vazhdoi krijimi i formacioneve “Kreshnike”, si dhe me vullnetarë që do të vepronin në rastet rreziku.⁸⁰

“Sami Frashëri” në Prishtinë, në prezencën e kryeministrit të Shqipërisë, Rexhep Mitrovicës, Xhafer Devës, Bedri Pejanit, Xhelal Mitrovicës, Ymer Berishës, Ibrahim Kelmendit, Luan Gashit, J. Fushës, Hysen Prishtinës, Jusuf Agushit, Avdyll Hencit dhe të autoriteteve të vendit e të përfaqësuesve të shtresave të ndryshme të qytetit. Prezenca e njerëzve në këtë mbledhje ishte jashtëzakonisht e madhe dhe arrinte numrin e mbi 3000 personave. Është quajtur Asamble e Përgjithshme e Rinisë. Shih në: Shatri, *Kosova*, 197.

⁷⁷ Shatri, *Kosova*, 196-197.

* Plava, Gucia dhe Rozhaja në fakt përfaqësoheshin vetëm nga N. Basha.

⁷⁸ Për udhëheqjen e Seksionit Ushtarak u ngarkua A. Boletni, Seksioni i Financave R. Meta, Seksioni i Ekonomisë, Sh. Basha, Seksioni i Rinisë B. Gjino, ai Sanitar B. Shporta, të Seksionit të Përgjithshëm Tahir Zajmi.

⁷⁹ Shatri, *Kosova*, 198.

⁸⁰ *Fletorja zyrtare*, Nr.12, 17 mars 1944, fl.1-5. Aprovimi i Statutit të Organizatës “Lidhja II e Prizrenit”.

Xhafer Deva, që mbante po ashtu pozitën e ministrit të Punëve të Brendshme në qeverinë shqiptare, kishte rënë dakord me komandën gjermane të pushtimit për plotësimin e efektivave të Divizionit “Skënderbeg”, ndërsa për organizimin dhe drejtimin e tij u ngarkuan oficerët gjermanë. Është me rëndësi të theksohet se në këtë kuvend u formua edhe Gjyqi Ushtarak.⁸¹ Diplomacia gjermane e mbështeti Lidhjen e Dytë të Prizrenit me qëllim që ta shfrytëzonte atë në interes të planeve të saj⁸² dhe të bashkonte rreth këtij fronti të gjithë mbështetësit progjermanë.* Kjo qasje e diplomacisë gjermane binte ndesh me interesat kombëtare të shqiptarëve, për shkak se duke ndjekur interesat e saj, Gjermania shpërblente bashkëpunimin politiko-ushtarak me serbët, malazezët dhe bullgarët, me dhënien e trojeve shqiptare si shpërblim. Kjo lojë diplomatike, shkonte në kahe të kundërt me qëndrimet dhe synimet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, e cila ishte për një Shqipëri etnike, që aspironte bashkimin e mbarë kombit shqiptar, dhe e kishte specifikuar në statutin e saj.⁸³

Si përfundim, mund të themi se, organizata politike Lidhja e Dytë e Prizrenit kishte qëllim kryesor mbrojtjen e trojeve etnike nga rreziku sllav dhe bashkimin e të gjitha viseve shqiptare në një shtet të vetëm. Mirëpo, bashkëpunimi me bllokun nazifashist, e pamundësoi realizimin e këtij qëllimi, ngase ky bllok e humbi luftën. Andaj, veprimtaria e kësaj organizate u shua më 17 nëntor 1944, pas fitoreve të njëpasnjëshme të aleatëve në frontet e luftës dhe të forcave komuniste në rajon. Në këto rrethana të vështira për Lidhjen, Komiteti Qendror miratoi mbajtjen e një mbledhjeje në Prizren, ku u vendos që të caktohej një delegacion për të udhëtuar në Selanik, për t’i paraqitur komandës aleate një memorandum. Në këtë memorandum do të shpjegoheshin arsyet e pozicionimit kundër forcave partizane jugosllave e bullgare dhe do të parashtrohej kërkesa e shqiptarëve të Kosovës për bashkim me Shqipërinë.⁸⁴

⁸¹ Shatri, *Kosova*, 199.

⁸² Dezhgiu, *Shqipëria*, 310-311.

* Sipas Komandës Gjermane, nacionalizmi bullgar mund të kënaqej duke aneksuar qendrat shqiptare si Tetovën Gostivarin dhe Kërçovën. Nacionalizmi malazez do të kënaqej sikur rreth saj do të mund të bashkoheshin krahinat e Sanxhakut; nacionalizmi serb do të kënaqej nëse në kuadër të shtetit kuisling serb do të përfshiheshin qarku i Kosovës dhe mundësisht prefektura e Prishtinës. Kështu, në bazë të politikës gjermane nacionalizmi shqiptar do të pajtohej në rast se u premtohej që në përbërje të Shqipërisë do të përfshiheshin Rrafshi i Dukagjinit, Dibra dhe Struga etj.

⁸³ *Fletorja zyrtare*, Nr.12, 17 mars 1944, fl.3. Aprovimi i Statutit të Organizatës “Lidhja II e Prizrenit”.

⁸⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. IV, 140.

Haxhi ADEMI

SUMMARY

POLITICAL LIFE IN KOSOVO IN THE YEARS OF THE SECOND WORLD WAR (1941-1945)

This study elaborates on the political life in Kosovo during the period of the Second World War, when Kosovo was occupied and divided into three occupation zones. In addition to general developments, political life was conducted in these zones. The majority of Albanians were aware that the unification of Albanians was a result of circumstances and interests of Fascists Block and events created by the beginning of the war, and that they should use this momentum to achieve long-term national interests. Therefore, the years of war in the global aspect were the most difficult years for Albanians, as they were in very specific and complicated circumstances, but anyway they are remembered as a period of progress for the Albanian issue. But, not always the internal factor is the determinant of subsequent flows. It was the external factor (Italian and German) that, for its purposes, realized the aspiration of the Albanians exactly at the time when Europe was gripped by a nightmare.

Despite the advantages, as a result of the unification of the Italian area with Albania, in the war years, Kosovo faced very difficult and complicated circumstances for several reasons such as: the situation inherited from the Kingdom of Yugoslavia, national contradictions, its division into three areas of occupation, the demagogic policy of the occupier, the "liberation" and the illusion of the unification of the Albanians, the anti-Yugoslav mood, etc. Therefore, this article elaborates various political currents (Fascist Party, People's League, Balli Kombëtar, Second League of Prizren, Communist Party of Yugoslavia, Albanian National-Democratic Organization, etc.), which operated and clashed in Kosovo. Also, in this paper we discuss all these political entities (establishment, members, spirit-program, activities and influence), to reflect their role in the political processes in Kosovo during the years of World War II.